

BEQIR META

**MARRËDHËNIET E ANSELMO LOREKIOS
ME FEDERATËN “VATRA”***

Qysh me themelimin e Federatës Panshqiptare “Vatra”, atdhetari veteran Anselmo Lorekio shprehu gëzimin e tij për këtë subjekt të ri në fushën e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe i uroi “fat shoqërisë së re të sapokrijuar për të mirën e Shqipërisë e të shqiptarëve, veçanërisht në ato momente të shquara të zgjimit të ndërgjegjes shqiptare”¹.

Më tej marrëdhëniet e tij me “Vatrën” vijuan të ngrohta duke u përpjekur bashkarisht për të mirën e çështjes shqiptare. Por ato do të kulmonin në vendimin e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të “Vatrës” që u mbajt në fund të dhjetorit 1918. Vendimet e këtij kuvendi dhe programi që ai shpalli patën një rëndësi vendimtare për orientimin e Lëvizjes Kombëtare në SHBA e më gjerë.

Kuvendi vendosi që të fuqizohej delegacioni i “Vatrës” në Europë. Në Paris u caktuan të shkonin F. Noli e Rasih Dino, ndërsa Anselmo Lorecchio, Aubrey Herbert, Telford Erickson, Faik Konica e Sotir Peci u emëruan si delegatë nderi.

Kuvendi i “Vatrës” vendosi që pikësëpari delegatët e “Vatrës” në Paris dhe në kryeqytete të tjera të përpiqeshin në Konferencën e Paqes për një Shqipëri të pavarur, me kufijtë e saj etnikë dhe natyrorë duke përfshirë brenda tyre gjithë territoret thjesht shqiptare, që i ishin shkëputur Shqipërisë nga Konferenca e Londrës.

Së dyti, Kuvendi vendosi që Shqipëria të orientohej në politikën e jashtme drejt miqësisë me Italinë. Ai u rekomandoi delegatëve të “Vatrës” në Europë “të fitonin simpatinë mirëdashëse të qeverisë italiane” për të cilën gjykohej “se kishte interesa të veçanta për restaurimin e një Shqipërie të fortë përtej Adriatikut”. Kuvendi vlerësoi “përkrahjen që po i jepte vendit tonë qeveria italiane në luftën kundër lakmive të fqinjëve ballkanas”².

Anselmo Lorekio i pranoi këto vendime dhe u angazhua për të mbështetur vijën politike të “Vatrës”. Ai dha një kontribut të çmuar në kuadrin

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore të organizuar nga Fedarata Panshqiptare “Vatra”, me rastin e 100-vjetorit të botimit të gazetës “Dielli”, New York, 13 qershor 2009.

¹ *La Nazione Albanese*, nr. 17, 15 shtator 1912.

² “Rreth bisedimeve dhe vendimeve të Kuvendit”, *Dielli*, 3 janar 1918.

e delegacionit të “Vatrës” në Evropë, i cili punoi shumë në mbrojtje të çështjes shqiptare gjatë kohës kur Konferenca e Paqes zhvillonte punimet në Paris.

Në periudhën e parë të punimeve të Konferencës gjatë muajve janar-prill 1919 Lorekio dhe delegatët e tjerë të “Vatrës” u përpoqën shumë që Konferenca të vendoste për ribashkimin e trojeve të shkëputura nga Konferenca e Londrës me shtetin shqiptar. Ata dërguan telegrame e memorandumë të shumta në adresë të Konferencës dhe udhëheqësve të Fuqive të Mëdha në të cilët kërkohej bashkimi i Kosovës dhe i Çamërisë me Shqipërinë.

Gjatë tre muajve të parë të punimeve të Konferencës së Paqes marrëdhëniet e “Vatrës” me Italinë ishin përgjithësisht të mira. Kjo për faktin se ende nuk ishin shtruar hapur në tryezë kërkesat italiane për Vlorën dhe për protektoratin mbi Shqipërinë. Gjithashtu gjatë kësaj kohe përfaqësuesit italianë në Komitetin e Çështjeve Greke, De Martino dhe F. Kastoldi kishin këmbëngulur që Shqipëria të ruante kufijtë e vitit 1913. Madje, ajo kishte përqendruar forca në kufijtë jugorë të Shqipërisë për të penguar ndonjë aksion të mundshëm të Greqisë kundrejt Shqipërisë së Jugut. Në këto rrethana si Lorekio ashtu dhe delegatët e tjerë të “Vatrës” ushqyen shumë shpresa se qeveria italiane do të mbështeste çështjen shqiptare.

Por situata ndryshoi kur doli në pah propozimi amerikan për protektoratin italian dhe Vlorën. Tashmë Lorekio dhe anëtarët e tjerë të Delegacionit të “Vatrës” luftuan kundër protektoratit italian. Ata u përpoqën të sensibilizonin opinionin shqiptar dhe të huaj për rreziqet e tij. Në mënyrë specifike Lorekio e bëri këtë në Itali dhe ndërmjet arbëreshëve.

Në mes të prillit të vitit 1919 diskutimi i çështjes shqiptare në Konferencë arriti në një pikë delikate. Lorekio ashtu si personalitetet e tjera të shquara që bashkëpunonin me “Vatrën” (Mithat Frashëri, Mihal Turtulli, Mehmet Konica, Rasih Dino etj.) gjykuan se në këtë situatë duhej bërë një lëvizje politike duke demaskuar dhe denoncuar hapur dhe me përparësi politikën italiane, sepse Italia, me përpjekjet e saj për të vendosur protektoratin dhe për të aneksuar Vlorën, po jepte e para shembullin e zbatimit të Traktatit të Fshehtë të Londrës për copëtimin e Shqipërisë dhe, gjithashtu, politika italiane po komprometonte përpjekjet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në qarqet politike evropiane.

Në memorandumun e majit të vitit 1919 dërguar në emër të Federatës “Vatra” Konferencës së Paqes në Paris, i cili është nënshkruar nga Anselmo Lorecchio, Fan Noli, Rasih Dino, Nikolla Kasneci nga Himara, Aubrey Herbert, Telford E. Erickson, Faik Konica, Sotir Peci dhe Kostandin Çekrezi³, thuhej: Duke iu referuar mesazhit të Presidentit Wilson të datës 23 janar 1917, se të drejtat dhe garancitë e paqes do të ishin njëjloj si për kombet e vegjël edhe për të mëdhenj, kërkojmë që ky parim të zbatohet në mënyrë strikte edhe për

³ *La Nazione Albanese*, 15 mars 1919, nr.6, Memorandum presentato dalla Pan-Albanian Federation “Vatra” alla Conferenza della Pace in Parigi (1919).

Shqipërinë. Në memorandum thuhej se “shqiptarët nuk morën pjesë në luftën evropiane, por vuajtën më shumë se popujt e tjerë”.

Memorandumi ashtu si dhe shumë publikime të tjera të Lorekios paraqiste historinë reale të kombit shqiptar dhe padrejtësitë historike që i ishin bërë atij qysh prej Kongresit të Berlinit dhe më tej me vendimet e Konferencës së Londrës. Në këtë dokument shqiptarët paraqiteshin si një popull që ndihmuan revolucionin xhonturk dhe bënë që të fitojë kushtetuta. Por më vonë xhonturqit u përpoqën t’i shtypnin të drejtat e tyre, gjë që shkaktoi kryengritjet e viteve 1910-1912.

Luftërat Ballkanike paraqiteshin në këtë memorandum si një kryqëzatë e sllavëve dhe e grekëve me frymëzim fetar. Konsekuencat e kësaj lufte, më së shumti, i pagoi Shqipëria e cila humbi një pjesë të madhe të territorit të saj.

Më tej argumentohej domosdoshmëria e tërheqjes së pretendimeve italiane kundrejt Vlorës. Në Memorandum thuhej se delegatët e qeverisë së Athinës dhe të Beogradit kanë guxuar ta shtypnin absurditetin dhe guximin e çmendur të rivendikimeve të tyre deri në përpjekjen justifikuese me vënien përballë, për aq sa është thënë, me situatën në të cilën gjendet Italia përballë Shqipërisë në Vlorë.⁴

Protesta e Delegacionit Shqiptar në prill të vitit 1919 u vlerësua nga “Vatra” si një dokument themelor që “për të parën herë bënte të njohur politikën tonë thjesht kombëtare përpara të huajve, hidhte poshtë të gjitha shpifjet dhe dyshimet që ishin drejtuar ndaj “Vatrës” dhe shqiptarëve nga të huajt, vendoste bazat e një politike kombëtare dhe forconte moralin e politikës sonë kombëtare midis gjithë patriotëve”⁵.

Memorandumi i përbashkët i delegacioneve të kolonive shqiptare i 15 prillit 1919 që denonconte hapur politikën italiane ishte në kundërshtim me qëndrimin e përgjithshëm dhe pritës të Qeverisë së Durrësit, i cili i përmbahej ende vijës së marrëveshjes dhe mirëkuptimit me Italinë.

Ata e konsideronin aneksimin e Vlorës prej Italisë si një çështje kyçe sepse ai do të shkaktonte një reaksion zinxhir dhe do të bënte të mundur vënien në jetë të Traktatit të Fshehtë të Londrës.

Në të vërtetë ndërmarrja e këtij hapi dhe ballafaqimi i hapur me diplomacinë italiane në atë kohë ka qenë një dilemë shumë e vështirë. Kompleksiteti i rrethanave dhe pozita tepër e vështirë në të cilën ndodhej Shqipëria në Konferencën e Paqes, refuzimi kategorik i Jugosllavisë dhe i Greqisë për t’u dhënë mbështetje shqiptarëve për një qëndresë kundër synimeve italiane, përpjekjet këmbëngulëse dhe të hapura të Greqisë për të aneksuar Shqipërinë e Jugut, animi i hapur i Francës dhe i Anglisë për zbatimin e

⁴ *Po aty*, Italia, nr. 9, 10 aprile 1919, f. 2-3, Direttore e Administratore Anselmo Lorecchio, Pallagorio (Catanzaro).

⁵ “Zbulimi i skemës”, *Dielli*, 29 prill 1919.

Traktatit të Fshehtë të vitit 1915 dhe rekomandimet e SHBA që kishin qenë e vetmja shpresë e shqiptarëve, për dhënien e Vlorës dhe protektoratit të Italisë dhe për cedimin e Gjirokastrës në favor të Greqisë, ishin arsye shumë serioze që diktonin moderacion ndaj diplomacisë italiane. Edhe pse ajo kërkonte Vlorën dhe protektoratin, kishte shumë shpresa se ajo do të kundërshtonte aneksimin e Shqipërisë së Jugut dhe synimet jugosllave në veri.

Lorekio dhe delegatët e tjerë të “Vatrës” në Konferencën e Paqes u përpoqën t’i kundërshtonin synimet italiane, greke e jugosllave duke u mbështetur në programin e presidentit Wilson për paqen, në parimet e këtij programi si e drejta e çdo kombi për të vetëvendosur dhe për t’u vetëmbrojtur, ndalimi i aneksimit të kombeve të vogla, në parimin e mbrojtjes së demokracisë kundër imperializmit, duke theksuar se politika e Italisë në Ballkan i kishte shfaqur hapur synimet e saj imperialiste ashtu si Rusia dhe Austria më parë. Angazhimi i Lorekios në drejtimin e duhur në këtë moment të vështirë historik ishte një provë tjetër e personalitetit të një atdhetari të shquar me profil të lartë dhe me një formim të shëndoshë politik, e ndershmërisë dhe e përkushtimit të tij ndaj çështjes shqiptare. Lorekio e vazhdoi bashkëpunimin me Vatrën deri sa jeta e tij u shua.

Vdekja e Lorekios u përjetua me dhimbje në Shqipëri. Parlamenti shqiptar mbajti zi për të dhe e nderoi kujtimin e tij duke nënvizuar faktin se ai ja kishte kushtuar gjithë jetën e tij çështjes shqiptare. Edhe shtypi shqiptar e vlerësoi lart këtë patriot të madh. Jorgji Meksi në gazetën “Ora e Maleve” në artikullin “Për një bamirës që s’do të harrohet kurrë” shkruante se gazetari i madh Anselmo Lorekio sakrifikoi gjithë jetën e tij në altar të atdheut ... E cili vallë u përpoq më tepër se Lorekio për formimin e Shqipërisë... ? Shumë vjet kisha nderin të isha bashkëpunëtori dhe korrespondenti i Lorekios. “Nuk kam takuar në jetën time një njeri me ideal më të lartë, me karakter më të drejtë, me zemër më të gjerë. Ai njeri u fundos në ideal të patris (atdheut) si Kurtioj i Romës në gropë. Nuk rronte veçse për patrin (atdheun). Edhe kundër Italisë qëndroi, kur pandehi se politika italiane i bënte dëm Shqipërisë. Tregoi një patriotizëm të tillë saqë analet e patriotizmit rrallë e ku japin shembullin e një ndjenje kaq të lartë e pa interes”⁶.

Faik Konica shkruante në gazetën “Dielli” se “ja dhe një tjetër nga kapedanët e vjetër të Lëvizjes Shqiptare u zhduk tani nga mesi ynë”.

“La Nazione Albanese” shumë herë e kundërshtuar me forcë nga “Albania” për disa pikëpamje të ndryshme mbi të pritmen e Shqipërisë, mbronte veten me gjallësi. Por këto luftëra mendimesh, sado të ashpra nuk linin shije të hidhur, dhe marrëdhëniet e mia personale me Don Anselmon, kurdoherë të mira, kishin marrë vitet e fundit një ngjyrë miqësie të ngushtë”. Më tej

⁶ *Ora e Maleve*, 18 tetor 1924.

Konica shkruante:⁷ “Që më 1896 dhe deri tani shpejt, Anselmo Lorekio, herë më dendur, herë më rrallë, vazhdoi së botuari “Nazione Albanese”-n, dhe në tërë atë kohë, mbante gjallë emrin e Shqipërisë ndër qindra shkrimtarë dhe politikanë në Itali e gjetkë. Numrat e fletores të botuara në kohën e luftës janë për të vënë re: shumë shtylla janë të bardha, se censura nuk i kishte pëlqyer shkrimet dhe kishte ndaluar botimin e tyre. Në kohën e luftës dhe pastaj, shqiptarët e Italisë – ata me kuptim dhe me ndërgjegje, se kish dhe shumë pa njërin dhe pa tjetrën – u ndodhën shumë herë në një pozitë të rëndë: si shqiptarë nga rrënja, u vinte keq për vendin e stërgjyshërve: si qytetarë të Italisë, ishin të lidhur me politikën italiane. Anselmo Lorekio tregoi mjaft hollësi në ato raste të ngushta dhe që i zoti të dalë faqebardhë.

Një gjë për të admiruar te Don Anselmo, ishte forca e zemrës me të cilën duronte mundimet e varfërisë, mundime të shtuara nga lufta. “Vatra”, duke emëruar për ca kohë Lorekion si delegat të saj, bëri një vepër shpërblimi të vyer kundrejt një njeriu i cili kish dhënë njëzet e pesë vjet të jetës së tij në mbrojtjen e kombit shqiptar”.

Gazeta “Ora e Maleve” shkruante⁸:

“Më 22 të marsit, mbas një lëngate të shpejtë, asht nda nga kjo jetë në Romë, në moshën 81 vjeç, ushtari i palodhur i përlindjes shqiptare në lamë të fletorsis, kavalieri. Anselmo Lorekio.

Ky zotni i paharrueshëm ish prej gjakut tonë, prej një familjet së përmendun të shqiptarëve të Italisë. Kishte lindur në Pallagoris, në një katund të vogël të arbëreshëve të Kalabrisë, më 1843. Pajisur mendërisht me një kulturë të shëndoshë e i ushqyem me ndiesina të nalta atdhedashurie u vu qysh i ri me një entuziazëm të madh për me i shërbye Shqipnis, vendit të të parvet të vet.

Në vitin 1895 mori pjesë në kongresin shqiptar, që u mbajt në Korigliano nën kryesi të idealistit të madh Jeronim De Radës. Dy vjet më vonë, më 1897, kryesoi kuvendin arbëresh të Lungros e qysh në atë vit nisi të botojë, së pari, në Pallagoris e mandej në Romë gazetën shqipe “La Nazione Albanese” me kryefjalën “Shqipëria përpara”, ndër shtylla të së cilës zhvilloi për 25 vjet rresht, me argumente të forta historike të drejtat e një populli të robnuem e ngjarjet e përshkimet e lëvizjes sonë kombëtare. Të gjitha koleksionet e kësaj fletoreje janë një visar i çmueshëm, pse përmbajnë një lëndë fort të vlefshme e dokumente me rëndësi mbi zhvillimin politik e letrar të përlindjes së kombit tonë. Tepër i vështirë e i ashpër që veprimi i tij si fletorar, por me gjithë pengimet që hasi në zhvillim të punës, nuk u ligështua, sepse për të shtypi ishte arma më e fuqishme për të përhapur idenë kombëtare e për të punuar për independencën e një populli.

⁷ Dielli, Boston Mass., 3 maj 1924.

⁸ Ora e Maleve, Shkodër, 5 prill 1924.

Dhe me këtë shpresë punoi pa reshtur me një guxim të pashoq deri sa mbërriti me e pa të realizuar ëndrrën e vet, pavarësinë e Shqipërisë.

Ky ushtar i pendës ka botuar edhe disa libra në gjuhë italiane:

LA QUESTIONE ALBANESE; IL PENSIERO POLITICO ALBANESE E TANI MË SË FUNDMI L'ALBANIA, NJË VEPËR NË KATËR VËLLIME, NË TË CILËN JANË PËRMBLEDHUR AKTET E KËTYRE VITEVE TË FUNDIT TË ÇËSHTJES SHQIPTARE SI EDHE KA PËRKTHYER ITALISHT HISTORINË E MARIN BARLECIT DE VITA ET MORIBUS GEROGII CASTRIOTI. SHOQËRIA "VATRA", MBAS LUFTËS BOTËRORE, DUKE I ÇMUAR VEPRAT E MERITUARA TË TIJ, E EMËROI DELEGAT NË KUVENDIN E PAQES.

Për këtë veprim të pareshtur emri i këtij atdhetari të flakët ka për t'u kujtuar përherë me nderim e bindje prej brezave të reja e të ardhshëm dhe ka për t'u përmendur edhe në histori të përlindjes kombëtare.

Këto vlerësime të asaj kohe për Lorekion mbeten një pikë orientimi e respektueshme edhe sot për të çmuar dhe kuptuar rëndësinë e veprës së tij.